

Raport mbi braktisjen e shkollës

Përtej numrave të
braktisjes së arsimit të obligueshëm
në sistemin e Kosovës 2020-2023

Mars 2024



Misioni i OSBE-së në Kosovë dëshiron ta falënderojë Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe drejtoritë komunale të arsimit që kanë ndarë të dhëna dhe informacione të vlefshme për ta mundësuar hartimin e këtij raporti. OSBE-ja është e përkushtuar të punojë me të gjitha nivelet e institucioneve për të kthyer mbrapsht trendet e braktisjes së shkollës për të gjithë fëmijët në Kosovë.



Raport mbi braktisjen e shkollës

Përtej numrave të braktisjes së arsimit
të obligueshëm në sistemin e Kosovës
2020-2023

Mars 2024



Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave	4
I. Përmbledhje ekzekutive.....	5
II. Hyrje	6
III. Metodologjia dhe kufizimet.....	10
IV. Kuadri Ligjor.....	13
V. Çështjet që kontribuojnë në braktisjen e shkollës	16
VI. Vështrim i përgjithshëm dhe analizë	19
VII. Funksionimi i mekanizmave institucionalë të themeluar për të parandaluar braktisjen e shkollës.....	28
VIII. Funksionimi i reagimit joinstitucional të krijuar për të parandaluar braktisjen e shkollës.....	31
IX. Përmbyllje	32
X. Rekomandime.....	33
Shtojca 1	35



Lista e shkurtesave

ACFC	Komiteti Këshillimor për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
AGTSh	Anketa e Grupeve me Tregues të Shumëfishtë
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EMRBM	Ekipet e Parandalimit dhe Reagimit ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
NKK	Nënkryetari i Komunës për Komunitete
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Misioni i në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
RC	Qendra Rajonale, Misioni i në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim
SPH	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
UA	Udhëzim Administrativ
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Emergjencën e Fëmijëve
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim



I. Përmbledhje ekzekutive

Viteve të fundit Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka ndërmarrë hapa konkretë për monitorimin dhe zvogëlimin e numrit të braktisjes së shkollës në mbarë Kosovën. Të dhënat e ndara sipas komuniteteve mbledhen në nivel shkolle dhe kategorizohen në nivel komunal, kornizat ligjore për ekipet parandaluese janë miratuar, si dhe çdo vit shënohet java kundër braktisjes së shkollës. Po ashtu, është krijuar një sistem specifik që trajton braktisjet e mundshme. Megjithatë, problemi i braktisjes së shkollës, lënies së hershme të shkollës, vijimit të parregullt dhe mosregjistrimit në arsimin e obligueshëm nga fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian vazhdon të jetë shqetësues në Kosovë. Ndërkohë që është shënuar progres, vazhdon të ketë sfida, veçanërisht për komunitetet e cenushme. Mekanizmat e zbulimit të hershëm dhe instrumentet ligjore shpeshherë janë të mangëta, duke prekur në mënyrë joproporcionale fëmijët në këto komunitete. Për më tepër, mbledhja e të dhënave dhe koordinimi ndërmjet institucioneve në nivele të ndryshme vazhdon të jetë sfidues.

Hulumtimi i kryer për qëllime të këtij raporti identifikon një numër komunash që përjetojnë shkallë më të lartë të braktisjes së shkollës nga tre komunitetet më të cenushme dhe nga komuniteti shqiptar në një masë më të vogël. Ndërkohë që shumë faktorë kontribuojnë në braktisjen e shkollës, kushtet e këqija socio-ekonomike dhe diskriminimi i shpeshtë e intensifikojnë fenomenin.

Trajtimi i rasteve të braktisjes së shkollës dhe sigurimi i kthimit të fëmijëve në shkollë është i ndjeshëm nga aspekti kohor. Suksesi varet nga veprimi i shpejtë dhe të kuptuarit e thellë të shkaqeve bazë për të gjitha palët e përfshira. Institucionet duhet t'i japin prioritet kësaj çështjeje dhe të bashkëpunojnë në forcimin e mekanizmave dhe ndërhyrjeve ekzistuese administrative.

Pa ndërhyrje aktive dhe sistematike, praktika e lënies së hershme të shkollës do të vazhdojë, gjë e cila do të çojë në kufizim të perspektivave të punësimit të të rinjve dhe rritje të fuqisë punëtore të cenushme dhe të pakualifikuar. Përpjekjet urgjente dhe të koordinuara janë thelbësore për ta thyer këtë cikël dhe për të promovuar një sistem arsimor më gjithëpërfshirës në Kosovë.

II. Hyrje

Raportet ndërkombëtare shpesh citojnë shkallë të lartë të braktisjes së shkollimit të obligueshëm për studentët joshumicë në sistemin arsimor të Kosovës. Raporti i fundit i OSBE-së për braktisjen e shkollës në Kosovë u publikua nga Misioni në vitin 2012. Raporti i vitit 2012 theksoi një mungesë të konsiderueshme të të dhënave zyrtare të besueshme në lidhje me braktisjen e shkollës, kryesisht për shkak të mekanizmave joadekuat të monitorimit nga shkollat dhe institucionet e tjera përgjegjëse.¹ Pesë raportet më të fundit të Komisionit Evropian për Kosovën kanë treguar numër të lartë të braktisjes së shkollës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe kanë theksuar mungesën e statistikave të besueshme për rastet e tilla.² Opinioni i Pestë i Këshillit të Evropës për Komitetin Këshillëdhënës të Kosovës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (ACFC), gjithashtu e thekson braktisjen e shkollës në mesin e të tre komuniteteve të njëjta.³ ACFC vëren se “vijimi i arsimit fillor është pothuajse universal për popullatën shumicë, ka mbetur në 84 për qind për romët, ashkalitë dhe egjiptianët, prandaj ka mbetur në të njëjtin nivel si pesë vjet më parë”.⁴ Sipas UNICEF-it, gjashtë (6) për qind e djemve dhe dy (2) për qind e vajzave nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian që vijojnë shkollimin e mesëm të ulët janë në rrezik të braktisjes për shkak se janë dy apo më shumë vite më të moshuar se sa mosha përkatëse për klasën të cilën e vijojnë.⁵

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) mbledh të dhëna për braktisjen e shkollës përmes Sistemit të Menaxhimit dhe Informacionit në Arsim (SMIA). Ky sistem gjurmon të dhënat e braktisjes së shkollës në mënyrë retroaktive kundrejt numrit të nxënësve që janë regjistruar në vitin e mëparshëm (shtator). Ekipet e Misionit të OSBE-së në Kosovë në terren kanë mbledhur të dhëna për braktisjen e shkollës që

1 Misioni i OSBE-së në Kosovë, Përcjellja e braktisjes dhe mosvijimit të shkollës në Kosovë, shtator 2012, në dispozicion në, <https://www.osce.org/kosovo/95112>.

2 *Duhet të merren masa për të adresuar shkallën e lartë të braktisjes së shkollës në mesin e fëmijëve romë dhe ashkali, duke përfshirë mbështetjen dhe lehtësimin e punës së Qendrave Mësimore*, Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën i vitit 2019, 29 maj 2019, f. 72.

Duhet të merren masa për të adresuar shkallën e lartë të braktisjes së shkollës në mesin e fëmijëve romë dhe ashkali, Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën i vitit 2020, 06 tetor 2020, f. 85.


Shkalla e braktisjes së shkollës mbetet më e lartë në mesin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë edhe pse statistikave nuk janë të besueshme. Kosova duhet të rrisë mbështetjen për ekipet komunale për parandalimin e braktisjes së shkollës. Komisioni Evropian - Raporti i vitit 2021 për Kosovën, f. 93.

Shkalla e braktisjes së shkollës mbetet më e lartë në mesin e fëmijëve romë dhe ashkali edhe pse statistikave nuk janë të besueshme. Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën i vitit 2022, tetor, 2022, f.106 dhe Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën i vitit 2023, Nëntor 2023, f.106.

3 149 Komiteti Këshillëdhënës rithekson se sigurimi i qasjes së të gjithë personave që u përkasin pakicave kombëtare në arsim cilësor do të thotë se autoritetet duhet të veprojnë me vendosmëri, ndër të tjera, për të siguruar që të gjithë fëmijët (përfshirë romët) të regjistrohen siç duhet në shkolla dhe të monitorojnë arrijet shkollore, duke përfshirë shkallën e mungesave dhe braktisjes, shkrim-leximi, përfundimi i studimeve, notat, pabarazitë gjinore, qasja në nivele të larta arsimore dhe më pas qasja në punësim, Opinioni i Pestë për Kosovën i Komitetit Këshillëdhënës të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (ACFC), në dispozicion këtu [1680ab6a79 \(coe.int\)](https://www.osce.org/kosovo/1680ab6a79)

4 Ibid, faqe 22.

5 UNICEF, MICS, 2019-2020 MICS në Kosovë & 2019-2020 MICS me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë Foto statistikore, në dispozicion këtu, [MICS Snapshots .pdf \(unicef.org\)](https://www.unicef.org/kosovo/files/2021/06/MICS_Snapshots.pdf)



kanë ndodhur në grupe dhe kanë kërkuar më shumë informacion mbi motivet e braktisjes si dhe çdo informacion përcjellës në komunë.

Ky raport ofron përmbledhje të braktisjes së shkollës nga komunitetet joshumicë nga sistemi arsimor i Kosovës ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, analizon shkaqet e rasteve individuale dhe shqyrton iniciativat e suksesshme për kthimin e fëmijëve në shkollë, sipas mandatit të OSBE-së për të monitoruar dhe promovuar të drejtat e njeriut. Raporti përdor këto dy grupe të dhënash për të krijuar modele dhe për të identifikuar trendet në komunitete dhe lagje me shkallë akute të braktisjes së shkollës në radhët e nxënësve të komuniteteve jo-shumicë. Përveç kësaj, raporti do të nxjerrë mësim dhe do të bëjë rekomandime nga shqyrtimi i rasteve kur nxënësit janë kthyer me sukses në shkollë.

Fenomeni i braktisjes së shkollës në Kosovë është reduktuar shumë për komunitetin shumicë dhe pothuajse ka arritur regjistrim dhe vijueshmëri universale. Megjithatë, shkalla e braktisjes së shkollës në mesin e studentëve jo-shumicë, veçanërisht fëmijëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, nuk e ka ndjekur të njëjtin model. Të dhënat e mbledhura nga MASHTI nga viti 2019 – 2023 tregojnë qartë trende të ndryshme për tre komunitetet më të cenueshme.


Popullsia rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë

Sigurimi i të dhënave të sakta demografike për popullsinë e komuniteteve në mbarë Kosovën është sfidues, pasi që jo të gjitha komunitetet morën pjesë në regjistrimin e popullatës të vitit 2011, regjistrimi nuk u krye në katër komunat veriore dhe lëvizjet e fundit të popullsisë në lidhje me migrimin dhe riatdhesimin nga Evropa Perëndimore i kanë shtrembëruar shifrat. Duke e pas parasysh këtë, mund të arrihen vlerësime të arsyeshme duke përdorur regjistrimin e vitit 2011 së bashku me profilet komunale të OSBE-së për vitin 2018, të cilat përfshijnë vlerësime joformale të bëra nga Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKK), personat e riatdhesuar dhe hulumtimet shtesë në terren.

Romët e Kosovës janë nga komunitetet më të vjetra në Kosovë. Sipas regjistrimit të popullatës të vitit 2011, në Kosovë ishin 8,824 romë. Megjithatë, regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 u bojkotua pjesërisht nga komuniteti rom. Në fakt, romët e Kosovës konsiderohen të jenë komuniteti i gjashtë më i madh në Kosovë.⁶

Romët e Kosovës banojnë në numrin më të madh në komunën e Prizrenit (ku përfaqësojnë 1.63 për qind të popullsisë së përgjithshme). Një pjesë e konsiderueshme e komunitetit banon në komunat perëndimore të Pejës (1.03 për qind) dhe Gjakovës (0.78 për qind), si dhe në Graçanicës (6.98 për qind), Obiliqit (3.07 për qind), dhe Mitrovicës

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës 1948–2006* (2008).



Jugore (0.73 për qind). Komunitetet më të vogla rrome gjenden të shpërndarë në mbarë pjesën tjetër të Kosovës.⁷

Sipas regjistrimit të popullatës të vitit 2011, në Kosovë jetojnë 15,436 pjesëtarë të komunitetit ashkali.⁸ Megjithatë, përsëri jo të gjithë ashkalitë e Kosovës morën pjesë në regjistrimin e popullatës, i cili nuk u mbajt në katër komunat veriore. Bazuar në të dhënat e siguruar nga regjistrimi i vitit 2011 dhe profilet komunale të OSBE-së 2018, komuniteti vlerësohet të përbëjë afërsisht 0.83 për qind e popullsisë së përgjithshme.

Popullsia më e madhe e komunitetit është në komunën e Ferizajt, ku është komuniteti i dytë më i madh (3.34 për qind e popullatës në komunë) pas shqiptarëve (95.9 për qind). Komuniteti ashkali është gjithashtu komuniteti i dytë më i madh në komunat e Mitrovicës Jugore (0.9 për qind), Podujevës (0.77 për qind), Fushë Kosovës (9.27 për qind), Lipjanit (3.15 për qind), Shtimes (2,74 për qind), Rahovecit (0,72 për qind) dhe Suharekës (0,83 për qind). Grupe më të vogla ashkali gjenden të shpërndarë në pjesën tjetër të Kosovës.⁹

Komuniteti egjiptian është komuniteti i katërt më i vogël në Kosovë¹⁰, përbëhet nga 11,524 persona të regjistruar gjatë regjistrimit të vitit 2011, që përfaqësojnë 0.66 për qind të popullsisë.¹¹

Egjiptianët jetojnë kryesisht në perëndim të Kosovës, dhe përqendrimi më i madh i komunitetit është në komunën e Gjakovës (ku ata përfaqësojnë 5.42 për qind të popullsisë komunale). Egjiptianët gjithashtu banojnë në komunat e Pejës (2.77%), Istogut (3.78%) dhe Klinës (2.39%).¹² Përqendrime më të vogla të komunitetit egjiptian gjenden gjithashtu në mbarë Kosovën.

⁷ OSBE, *Profilet Komunale 2018* (2019).

⁸ Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë, *Komunitetet Pakicë në Regjistrimin e Popullatës të vitit 2011 në Kosovë: Analiza dhe Rekomandime*, <https://www.ecmikosovo.org/uploads/3engA.pdf> (qasur më 27 janar 2022).

⁹ Të dhënat nga baza e brendshme e të dhënave e Misionit të OSBE-së në Kosovë për profilet komunale, 2018.


¹⁰ Vetëm komunitetet goran, malazez dhe kroat janë më të vogla.

¹¹ OSBE, *Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian në Kosovë* (janar 2020), f. 4.

¹² OSBE, *Profilet Komunale 2018* (Janar 2019).



Raporti mesatar i braktisjeve sipas numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin e obligueshëm (2019 -2023)



Grafiku 1. Raporti mesatar i braktisjeve sipas numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin e obligueshëm (2019 -2023)

Grafiku i mësipërm ilustron shtrirjen e problemit brenda tre komuniteteve. Të dhënat e MASHTI për braktisjen e shkollës nga komunitetet tjera joshumicë që jetojnë në Kosovë nuk përbëjnë shqetësim.¹³

¹³ Nga 2019 deri 2023. Të dhënat nga EMIS të MASHTI-t tregojnë për një braktisje nga komuniteti serb në vitin 2022/2023, dy braktisje nga komuniteti turk në vitin 2020/2022, dy braktisje nga komuniteti boshnjak në vitin 2022/2023 dhe asnjë braktisje nga komuniteti goran dhe kroat në Kosovë.

III. Metodologjia dhe kufizimet

Mes viteve 2020 dhe 2023, stafi në terren i Qendrës Rajonale të OSBE-së (QR) në Prizren, Prishtinë, Pejë, Gjiilan dhe Mitrovicë u ndërlidh me drejtoritë komunale të arsimit (DKA), shkollat dhe organizatat joqeveritare (OJQ), për të mbledhur të dhëna për mbi 400 fëmijë të cilët ose e kanë braktisur shkollën ose janë në rrezik të braktisjes së shkollës fillore dhe të mesme të ulët (klasat I-IX). Arsyet e braktisjes përfshijnë: **distanca fizike nga shkollat, mungesa e transportit ose transporti i papërbalueshëm, shqetësimet e sigurisë së përgjithshme, shqetësimet e sigurisë personale** (qentë endacakë, mungesa e trotuareve), **martesat e hershme, edukimi i papërbalueshëm, kujdesi për anëtarët e familjes, çështjet shëndetësore, vendimet e prindërve, të qenit më i vjetër se shokët e klasës dhe mungesa e motivimit**. QR-të hetuan rastet individuale dhe 'grupuan' rastet e ofruara nga DKA-të dhe OJQ-të për të kuptuar natyrën e mungesave të zgjatura. Pasi u zgjidhën rastet, informacioni u përditësua në bazën e të dhënave për të pasqyruar situatën aktuale. Baza e të dhënave synon të mbajë një pasqyrim në kohë reale dhe historike të rasteve të braktisjes masive të nxënësve nga të gjitha komunitetet anembanë Kosovës, por nuk synon të kapë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha rastet e braktisjes.

Kufizimet

Koha e mbledhjes së parë të të dhënave përkoi me shpërthimin e COVID-19, gjë që ka ndikuar në pjesëmarrjen e rregullt në të gjitha fushat e shoqërisë. Ndonëse është një çështje madhore në vetvete, ajo gjithashtu ka përkeqësuar vijimin e rregullt në shkollë për komunitetet më të marginalizuara. Nxënësit kishin vështirësi të veçanta në ndjekjen e orëve online pa pajisje elektronike dhe pa mbikëqyrjen e mësuesve.¹⁴ Një çështje tjetër që duhet pasur parasysh është përkufizimi i gjerë i asaj që nënkuptohet me "braktisje":

- 1. Rastet e evidentuara nga ekipet në terren janë nxënës të cilët kanë vijuar mësimet, por tani i kanë ndërprerë. Kjo nuk ka të bëjë me nxënësit që nuk janë regjistruar kurrë në shkollë ose nxënësit që nuk kanë kaluar nga njëri viti në tjetrin.*
- 2. Një kufizim tjetër është mungesa e të dhënave në dispozicion nga DKA-të. Në disa raste, ato nuk janë në gjendje të japin informacion për shkollat individuale, komunitetin të cilit i përket një nxënës dhe arsyet e mosvijimit. Për më tepër, drejtoritë komunale të arsimit të sistemit të Kosovës nuk mbledhin të dhëna për nxënësit serbë që ndjekin sistemin shkollor në gjuhën serbe. Për këtë arsye, ky raport fokusohet në ata që braktisin shkollën nga sistemi i Kosovës me rekomandime drejtuar shkollave, drejtorive komunale të arsimit të Kosovës dhe MASHTI-t.*

¹⁴ Sipas Balkans Sunflowers Kosova, një OJQ lokale që punon në çështjet e arsimit, rreth 70 për qind e nxënësve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian i Kosovës nuk i kanë ndjekur rregullisht mësimet online gjatë pandemisë Covid-19.



Grupet

Ekipet e OSBE-së në terren mblodhën të dhëna për 'grupet' e atyre që e kanë braktisur shkollën. Grupet përkufizohen si më shumë se një rast i braktisjes që ka të njëjtin komunitet, klasë shkollë dhe motiv për braktisje. Ata janë grupuar për të zbuluar raste të zakonshme të përjetimit të shkaqeve të ngjashme për të lënë shkollën. Në këtë mënyrë, duhet të bëhet një ndërhyrje gjithëpërfshirëse qoftë në nivel të shkollor, komunal apo qeveritar, varësisht nga arsyeja, me qëllim të adresimit të çështjes. Ky mjet përcjellës nuk synon të regjistrojë të gjitha rastet e braktisjes së shkollës në Kosovë. Ai tregon vetëm kur numri i rasteve është i lartë dhe kur prek komunitetet jo-shumicë, por të dhënat e mbledhura ofrojnë një pasqyrim që nuk përfshihet në të dhënat e MASHTI-t, siç është motivi për braktisje dhe përcjellja e rasteve, për të identifikuar mësimet e nxjerra.

Të dhënat e MASHTI-t

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsimit (SMIA) i MASHTI-t mbledh të dhëna për braktisjen e shkollës për studentët që janë regjistruar në vitin paraprak (shtator). Këto të dhëna paraqesin lista të braktisjes së shkollës sipas klasës, komunës, komunitetit¹⁵ dhe gjinisë. Të dhënat futen nga mësuesit dhe më pas ndahen me drejtoritë komunale të arsimit dhe Ministrinë.

Të dhënat në SMIA ofrojnë përmbledhje të braktisjeve nga komunitetet e ndryshme, që tregon mënyrën se si do të përdoren të dhënat në këtë raport. Mirëpo, në disa raste, rastet e regjistruara nuk janë në fakt braktisje, por pasqyrojnë një nxënës që është zhvendosur në një komunë tjetër pa e informuar zyrtarisht shkollën. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për komunitetin shqiptar, tek i cili numrat shpesh mund të duken të fryra, por hulumtimi i të dhënave nga ekipet e OSBE-së në terren, ka treguar në disa raste se nuk kemi të bëjmë me braktisje, por transferime.

Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se të dhënat në SMIA gjenerojnë raporte vetëm në bazë të informacionit të futur në sistem. Nëse shkollat dhe mësuesit nuk janë vigjilentë në lidhje me regjistrimin e nxënësve që vijojnë në mënyrë të parregullt ose braktisin shkollën, atëherë kjo nuk do të reflektohet në sistem. Ky është problem i përsëritur dhe metodat e përdorura për të llogaritur rezultatet nga të dhënat e disponueshme shpesh kërkojnë vlerësime.

Ky raport do të shikojë të dy grupet e të dhënave dhe do të vlerësojë informacionin sasior dhe cilësor. Vlerësimi do të përfshijë analizën e të dhënave të OSBE-së për braktisjen nga nxënësit e komuniteteve kundrejt të dhënave të MASHTI-t mes viteve 2020 dhe 2023. Arsyet e braktisjes së shkollës nga nxënësit e komuniteteve të ndara sipas gjinisë do të

¹⁵ Komunitetet e përfshira në të dhënat SMIA-s përfshijnë: Komunitetin shqiptar, serb, turk, boshnjak, goran, ashkali, romë e egjiptianë, kroat etj.



analizohen dhe vlerësohen së bashku me përgjigjet e të intervistuarve. Rastet e zgjidhura gjithashtu do të analizohen në përpjekje për të identifikuar se cilat praktika janë më të suksesshme për kthimin e nxënësve në shkollë. Pas vlerësimit, do të ofrohen rekomandime për DKA-të dhe MASHTI-n.

OSBE-së nuk i janë ofruar të dhënat nga Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm të MASHTI-t dhe për këtë arsye nuk mund ta vlerësojë efektivitetin e atij mekanizmi.

IV. Kuadri Ligjor

Neni 22 i Kushtetutës përcakton se standardet dhe marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të barabarta ose, në rast konflikti, mbi të drejtën vendore.¹⁶ Kjo dispozitë përfshin të gjitha marrëveshjet kryesore që kanë të bëjnë me qasjen në arsim dhe detyrimin e nënshkruesit për të ofruar arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët.¹⁷


Neni 5 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar thotë se është detyrë Ministrisë që të “promovojë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimin; të sigurojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësit dhe të punësuarve në institucionin arsimor dhe aftësues, si dhe të avancojë masat për parandalimin e braktisjes”.

MASHTI ka zhvilluar politika dhe legjislacion për të luftuar braktisjen e shkollës. Masa të tilla përfshijnë krijimin e Ekipeve për Parandalim dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM) në nivel shkollor, komunal dhe të MASHTI-t. Këta mekanizma u krijuan për herë të parë në vitin 2012 dhe një EPRBM në nivel të MASHTI-t dhe grumbullimi i centralizuar i të dhënave u shtuan përmes Udhëzimit Administrativ 08/2018 për Krijimin dhe Forcimin e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar. EPRBM në nivel shkolle përbëhet nga pesë anëtarë: drejtori i shkollës, përfaqësuesi i mësuesve, përfaqësuesi i nxënësve, përfaqësuesi i prindërve, si dhe ekspertë shtesë kur është e nevojshme (si OJQ-të). Menaxheri përkatës është i obliguar që për punën e tyre t'i raportojë grupit çdo tre muaj dhe Drejtorisë komunale të arsimit (DKA) çdo gjashtë muaj.¹⁸ EPRBM në nivel komunal përbëhet nga nëntë anëtarë: dy përfaqësues të DKA-së, një përfaqësues nga këshilli i prindërve, një përfaqësues i këshillit të nxënësve, një drejtor shkolle, një përfaqësues nga departamenti i mirëqenies, një përfaqësues nga drejtoria për çështje sociale, një përfaqësues nga drejtoria e shëndetësisë, një përfaqësues nga zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) dhe shoqëria civile të cilët kanë ekspertizë në fushën e përfshirjes në arsim cilësor. EPRBM-ja komunale është e obliguar që çdo tre muaj të

¹⁶ Kushtetuta, neni 22, Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

¹⁷ (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

¹⁸ Udhëzimi Administrativ 08/2018, Për krijimin dhe forcimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, neni 5.



takohet dhe t'i raportojë drejtorit komunal të arsimit dhe MASHTI-t.¹⁹ Në nivel të MASHTI-t, EPRBM-ja mbikëqyr zbatimin e politikave për EPRBM-të.²⁰ Moduli i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH) synon të mbledhë të dhëna cilësore dhe sasiore nga shkollat dhe DKA-të për rastet në rrezik të braktisjes dhe të përcjellë sistemin e referimit dhe trajtimin e rasteve.²¹ Sipas UA 08/2018, aktivitetet e EPRBM-së financohen nga MASHTI, DKA-të dhe ndihma e donatorëve.²², dhe për mosrespektim janë paraparë masa ndëshkuese dhe disiplinore.²³

Neni 15 i Ligjit për arsimin parauniversitar përcakton se është përgjegjësi e komunës që të sigurojë transport për nxënësit në arsimin e obligueshëm. Kjo dispozitë përkufizon më tutje studentët që jetojnë brenda zonës lokale, por katër kilometra larg shkollës dhe studentët që jetojnë jashtë zonës lokale.²⁴ Ky ligj gjithashtu vendos përgjegjësinë për regjistrimin dhe vijimin e arsimit të obligueshëm mbi prindërit, ku mosregjistrimi, mosvijimi përmes veprimeve të qëllimshme ose neglizhencës mund të rezultojë në ndëshkim. Në raste të tilla, përgjegjësia i takon komunës që të raportojë në ministri.²⁵

Neni 5 i Udhëzimit Administrativ 04/2013 për Parashtrimin e kërkesave dhe procedurat për ndihmë sociale kërkon që certifikatat e shkollës për fëmijët e moshës 6–14 dhe 15–18 vjeç t'i bashkëngjiten kërkesës fillestare ose asaj për vazhdimin e ndihmës sociale.²⁶

Përveç ligjeve dhe akteve nënligjore, Strategjia e Arsimit e Kosovës 2022-2026 dhe Strategjia për Avancimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë 2022-2026 trajtojnë gjithashtu çështjen e braktisjes së shkollës. Strategjia e Arsimit përfshin objektivin specifik 2.3: për rritjen e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve nga grupet e marginalizuara nëpërmjet krijimit të një klime motivuese dhe mbështetëse në treguesin e rezultatit “Përqindja e braktisjes në arsimin e obligueshëm dhe të mesëm të lartë”. Ndërsa Strategjia për Romë dhe Ashkali parasheh qëllimin strategjik në vijim për arsimin: “Rritja efektive e ofrimit të mundësive, qasjes së barabartë dhe zhvillimit në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet rom dhe ashkali” duke synuar kështu zvogëlimin e braktisjes nga komunitetet përkatëse.

19 Udhëzimi Administrativ 08/2018, Për krijimin dhe forcimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrim të nxënësve në arsimin parauniversitar, neni 6.

20 Po aty. neni 7.

21 Po aty. neni 8.


22 Po aty. neni 9.

23 Po aty. neni 10.

24 Ligji Nr. 04/L-32 për Arsimin parauniversitar në Kosovë, neni 15.4.

25 Po aty. neni 15.5.

26 Udhëzimi Administrativ 04/2013 për parashtrimin e kërkesave dhe procedurat për ndihmë sociale, Neni 5, Dokumentet e nevojshme për plotësimin e kërkesës për ndihmë sociale, 1.12 Certifikata shkollore për fëmijët e moshës 15-18 vjeç (e detyrueshme), 1.13 Certifikata shkollore për fëmijët e moshës 6-14 vjet (e dëshirueshme) dhe neni 10, Dokumentet e nevojshme për vazhdim të ri të të drejtës së ndihmës sociale, 2, Familja, individit që paraqet kërkesë të re për vazhdimin e të drejtës së ndihmës sociale, kërkohet të përsërisë të gjitha dokumentet e kërkuara nga nën-paragrafi 1.9 deri në nënparagrafin 1.20 të nenit 5 të kësaj procedure.



Mbështetja për qendrat mësimore me bazë në komunitet është theksuar në të dyja strategjitë si masë për rritjen e regjistrimit në klasën e parë dhe zvogëlimin e braktisjes së shkollës të fëmijëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Ndonëse korniza ligjore është solide, EPRBM-të e nivelit shkollor dhe komunal janë vetëm pjesërisht funksionale²⁷, zbatimi i strategjisë konsiderohet sfidë²⁸ dhe ligji nuk zbatohet plotësisht. Pa një sistem të fortë e funksional, dukuritë e mosregjistrimit dhe braktisjes së fëmijëve nga komunitetet joshumicë do të vazhdojnë të jenë të zakonshme.

27 KOSINT 2020, Raporti i vlerësimit të efektivitetit të EPRBM-ve, Raporti i fokusuar në efektivitetin e EPRBM-ve në për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, gusht, 2019, i disponueshëm në: [raporti i fokusuar në efektivitetin of prtans among roma- ashkali 20.pdf](#)

28 KEEN, Vlerësimi Afatmesëm: Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021, nëntor, 2019, Prishtinë, në dispozicion në: [Implementation-of-Kosovo-Education-Strategic-Plan.pdf \(kosovoprojects.eu\)](#)



V. Çështjet që kontribuojnë në braktisjen e shkollës

Sipas UNICEF-it, gati 23 për qind e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri, me shtatë për qind që jetojnë në varfëri të skajshme, që është më e përqendruar në radhët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.²⁹ Ndonëse arsimiti i obligueshëm heq teksteve shkollore subvencionohen nga MASHTI, familjet më të varfra kanë vështirësi të përballojnë shpenzimet për veshmbathje, këpucë, çanta të shkollës, materiale shkollore dhe shpenzime tjera që nevojiten për dërgimin e fëmijëve në shkollë. Kushtet e këqija socio-ekonomike të shoqëruara me arritjet e ulëta arsimore dhe çështje tjera që rrjedhin nga kjo, kontribuojnë ndjeshëm në mungesat dhe braktisjen e shkollës. Çështja është shumëdimensionale me shumë faktorë ndërlidhës që kontribuojnë në braktisjen e shkollës.

Diskriminim

Diskriminimi anti-rom është i përhapur në mbarë Kosovën, jo më pak në sistemin arsimor. Kjo formë diskriminimi, e cilësuar ndonjëherë si ‘anti-gjipsizëm’ ka në shënjestër në mënyrë specifike romët, sintitë, çergashët dhe të tjerët që stigmatizohen si ‘magjupë’ në perceptimin publik.³⁰ Ky diskriminim manifestohet në stereotipe poshtëruese dhe gjuhë të urrejtjes, apo edhe dhunë, të cilat mund të kontribuojnë që fëmijët të mos ndjekin mësimet në mënyrë të rregullt dhe në mënyrë të pashmangshme e braktisin atë nëse nuk ndërmerren ndërhyrje adekuate. Strategjia 2022-2026 për Avancimin e të Drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali e njeh këtë lloj të veçantë të diskriminimit dhe si përgjigje ia ka kushtuar një shtyllë të veçantë që si për qëllim ka *parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, paragjyqimeve, stereotipeve dhe bullizmit*.³¹ Si dhe në kuadër të mekanizmave të ndërgjegjësimit dhe forcimit dhe raportimit, ekziston një fokus në promovimin e historisë dhe kulturës së komuniteteve joshumicë.


Transporti shkollor

Gjatë vitit 2022, ekipet në terren të OSBE-së realizuan një hulumtim mbi problemet e transportit shkollor në mbarë Kosovën, të cilat pengonin vijimin e rregullt të fëmijëve në shkollë. Shqetësimet rreth transportit janë vërejtur në mbarë Kosovën dhe kanë prekur të gjitha komunitetet. Studimi ka zbuluar 22 probleme të veçanta të transportit që kanë

²⁹ UNICEF, Raporti Vjetor për Kosovën 2022, fq 3, në dispozicion në: [Raporti Vjetor 2022 | Programi i UNICEF-it në Kosovë](#)

³⁰ Aleanca kundër antigjipsizmit, antigjipsizmi – Dokument referimi, korrik 2016, i disponueshëm në: [2016_07_05_Dokument_referues_për_antigjipsizmin_\(sintiundroma.de\)](#)

³¹ Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali në Kosovë 2022-2026, fq. 55



pasur ndikim në të shkollimit për mbi 475 fëmijë. Gjashtë nga këto raste kishin të bënin me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, ndërsa 16 raste kishin të bënin me nxënës të nivelit të mesëm të lartë ose nxënës me nevoja të veçanta. 14 ishin probleme të transportit ndërkomunal, ndërsa tetë ishin çështje të transportit ndërkomunal. 16 nga rastet përfshinin udhëtime për në shkollë në distancë prej 4 km ose më shumë dhe ishin në kompetencën e komunës, ndërsa gjashtë raste ishin nën distancën prej katër km, por përfshinin rrugë të rrezikshme për udhëtimin e fëmijëve për në shkollë p.sh., për shkak të rrugëve të ngarkuara, apo qenve endacakë. Transporti në shkollat speciale për fëmijët me nevoja arsimore shtesë është gjithashtu sfidues për disa prindër. Që atëherë disa raste janë zgjidhur përmes ndërhyrjeve komunale apo MASHTI-t, dhurimit të automjeteve apo marrëveshjeve ndërmjet prindërve dhe kompanive private, por shumë të tjera janë ende pa zgjidhje të qëndrueshme. Përpjekjet e koordinuara nga ministritë dhe komunat përkatëse duhet të drejtohen drejt sigurimit të transportit të përshtatshëm në përputhje me legjislacionin për banorë, veçanërisht fëmijët e shkollave.

Martetat e hershme

Vajzat nga të tre komunitetet përballen me sfida shtesë në qasjen në arsim për shkak të martesave të fëmijëve dhe/ose të detyruara³² dhe roleve tradicionale gjinore në këto komunitete. Në përgjithësi, 13.7 për qind e vajzave të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian nuk e vazhdojnë arsimin e lartë pas atij të ulët, krahasuar me 11.3 për qind të djemve nga komunitetet e tyre.³³ Përveç kësaj, katër për qind e vajzave nuk kalojnë nga arsimi fillor në atë të mesëm të ulët, krahasuar me 6.1 për qind të djemve nga i njëjti komunitet.³⁴ Martetat e fëmijëve janë nga faktorët që kontribuojnë në ndërprerjen e arsimit.³⁵ Sipas të dhënave të UNICEF-it nga viti 2021, një në tre gra dhe një në dhjetë burra (të moshës 20-24 vjeç) nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, janë martuar para moshës 18 vjeç, ndërsa arsimi dhe pasuria e ekonomisë familjare gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm në përcaktimin se kur një grua martohet.³⁶ Në Ligjin për Familjen në Kosovë, martesa nën 18 vjeç konsiderohet e paligjshme.³⁷ Mirëpo, martesat

32 Martetat e fëmijëve dhe të hershme janë terma që mbivendosen njëra me tjetrën. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë, fëmijë konsiderohet "çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>. Martetat e fëmijëve dhe të hershme janë ligjërish të njëjta gjë – martesa e një fëmije nën moshën 18 vjeç, ndërsa martesa e detyruar është martesë ku njëri ose të dy bashkëshortët, pavarësisht nga moshja e tyre, nuk kanë dhënë pëlqimin për bashkim.


33 Shih UNICEF në Kosovë, *Analiza e Situatës së Fëmijëve*, Tabela 16: Analiza e rrugëtimit në arsim për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian sipas gjinisë, f. 79.

34 Ibid.

35 Shih UNFPA, *Përmbledhje e martesës së fëmijëve në Kosovë* (2014), <https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/unfpa%20kosovo%20overview.pdf>

36 UNICEF, Fëmijët në Kosovë, 2021, në dispozicion në: [Fëmijët në Kosovë | Programi i UNICEF-it në Kosovë](#)

37 Në Ligjin për Familjen të Kosovës Nr. 2004/32, "Personi që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç nuk mund të lidhë martesë" (neni 16) përveç arsyeve të justifikuara kur një gjë e tillë mund të lejohet (neni 16b) dhe neni 18 e përcakton martesën e detyruar/të detyruar si "Martesa nuk do të jetë e plotfuqishme, nëse pëlqimi është arritur përmes shtrëngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo të ndonjë mungese tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm". <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18420>. Martesa e zakonshme (e paregjistruar) me personin nën moshën 16 vjeç është vepër penale, sipas nenit 239 të Kodit Penal. Martesa për



e tilla rrallë regjistrohen në komunë dhe zakonisht marrin formën e marrëveshjeve joformale ndërmjet familjeve. Një diskutim në fokus grup i organizuar nga një OJQ vendore në Fushë Kosovë zbuloi se motivet kryesore për martesat e hershme janë: gjendja e vështirë ekonomike, mungesa e edukimit tek të rinjtë dhe prindërit, traditat familjare, ruajtja e nderit, papjekuria e të rinjve, dëshira e prindërve për t'i "rehatuar" fëmijët e tyre, papunësia, mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimit të të rinjve dhe komunitetit për pasojat e martesave të hershme, paragjykimet e shoqërisë dhe komunitetit, si dhe diskriminimi ndaj vajzave".³⁸

personin mbi moshën 16 vjeçare është e mundur vetëm me miratimin e gjykatës, mund të gjendet në: [A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf \(rks-gov.net\)](#)

38 Partneriteti i ideve, *shkaqet e martesave të hershme në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës*, në dispozicion në, [Microsoft Word - Kërkim përfundimtar, anglisht \(theideaspartnership.org\)](#)

VI. Vështrim i përgjithshëm dhe analizë

Ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, ekipet në terren të OSBE-së mblodhën të dhëna për mbi 150 raste individuale dhe grupore të braktisjes së shkollës për më shumë se 400 fëmijë (nga klasa I-IX nga çdo rajon në Kosovë) të cilët ose e kanë braktisur shkollën, ose janë në rrezik për ta braktisur atë. Informacionet në dispozicion për rastet janë ofruar nga shkollat, drejtoritë komunale të arsimit dhe OJQ-të.

Në bazë të dhënave që janë mbledhur nga ekipet në terren të OSBE-së, tri komunitetet më të cenueshme, egjiptianët, ashkalisht dhe romët e Kosovës, shfaqin vijim më të parregullt të shkollës dhe kanë më shumë gjasa ta braktisin arsimin e obliguar.

Të dhënat sugjerojnë se çështja është e përhapur në mbarë Kosovën. Megjithatë, **rajoni i Pejës dhe i Prishtinës janë më të prekurit nga kjo dukuri, me 65 për qind të braktisjeve të regjistruara** nga këto dy rajone.³⁹ Në **Prishtinë dhe Pejë**, komunitetet më të prekura janë **komuniteti egjiptian dhe ashkali**, të cilët përbëjnë 52 për qind të braktisjeve të regjistruara.

Si vajzat ashtu edhe djemtë janë të prekur. Megjithatë më shumë **djemtë priren të braktisin shkollën nga klasa I deri në V**, veçanërisht nga **komuniteti ashkali në rajonin e Pejës, ku 75 për qind e braktisjeve të regjistruara nga klasa I deri në V ishin djem.**


Shumica e braktisjeve ndodhin nga **klasat VI deri në IX, në të cilat vajzat dhe djemtë egjiptianë dhe ashkali janë duke braktisur arsimin e obliguar në një numër të madh në rajonin e Pejës dhe Prishtinës. Vajzat ashkali janë më të prekura në rajonin e Mitrovicës**, ku 67 për qind e numrit të përgjithshëm të vajzave që braktisën shkollën në rajonin e Mitrovicës ishin nga komuniteti ashkali.

Rajoni i Prishtinës po shënon një numër të madh të braktisjes së shkollës si nga komuniteti ashkali, ashtu edhe nga komuniteti rom, por pa të dhëna të zëbërthyer në mënyrë të duhur është e vështirë të përcaktohet se kush është më i prekur.

Në rajonin e Prizrenit dhe atë të Mitrovicës djemtë e komunitetit shqiptar janë duke braktisur klasën VI deri në IX ku 81 për qind e djemve nga rajoni i Prizrenit dhe 55 për qind e djemve nga rajoni i Mitrovicës të cilët e kanë braktisur shkollën janë nga komuniteti shqiptar.

Për klasat I deri në V, arsyeja më e zakonshme e ofruar nga zyrtarët e shkollës për vajzat dhe djemtë që braktisin shkollën është 'mungesa e motivimit' me 'kushtet e këqija

³⁹ Të gjitha përqindjet në këtë pjesë janë llogaritje në bazë të dhënave të mbledhura nga OSBE-ja për braktisjen e shkollës, disa janë vlerësime ku të dhënat e zëbërthyer nuk ishin në dispozicion.



ekonomike/arsim të papërballueshëm' në vend të dytë. Për klasat VI deri në IX, arsyeja më e zakonshme e braktisjes së shkollës nga vajzat dhe djemtë është sërish 'mungesa e motivimit', ku 'kushtet e këqija ekonomike/arsimimi i papërballueshëm' është arsyeja e dytë më e zakonshme dhe 'të qenit më të vjetër se shokët e klasës' është arsyeja e tretë e afërt.

Aty ku EPRBM-të e shkollave dhe ato komunale janë aktive, ato mund të jenë të dobishme për kthimin e fëmijëve në shkollë. Kjo duhet të bashkërendohet me kujdes rast pas rasti, me të gjithë aktorët që kontribuojnë dhe angazhohen për zgjidhjen. Në nivel shkolle, vijimi duhet të monitorohet sipas detyrës, ku drejtorët e shkollave raportojnë rregullisht për rastet individuale tek EPRBM-të e nivelit të shkollës. Në nivel komunal, nga ana tjetër, EPRBM-të duhet të angazhojnë njerëzit e duhur për të trajtuar rastet individuale dhe duhet të ofrojnë fonde dhe lehtësira për orë mësimi shtesë kur është e nevojshme.

OJQ-të kanë dëshmuar të jenë shumë të dobishme si për identifikimin e fëmijëve që janë në rrezik për ta braktisur shkollën, ashtu edhe për kthimin e fëmijëve në shkollë në rajonet e veçanta ku ata veprojnë.

Të dhënat e MASHTI-it nga viti 2019 deri në vitin 2023 (shih shtojcën 1) tregojnë numra të lartë të braktisjes së shkollës për Gjakovën që prekin djemtë dhe vajzat nga komuniteti ashkali, shqiptar dhe egjiptian dhe braktisjet e larta nga Fushë Kosova që prekin komuniteti ashkali dhe egjiptian në të gjitha klasat.

Të dhënat nga MASHTI-i po ashtu tregojnë se djemtë shqiptarë braktisin shkollën në veçanti në komunat e Prishtinës, Prizrenit dhe Malishevës.

Pasqyrë e rasteve sipas rajonit

Rajoni i Pejës

Komunat Gjakovë, Istog, Klinë dhe Deçan në rajonin e Pejës janë duke përjetuar braktisje të shpeshtë nga fëmijët e klasave I deri në IX nga **komuniteti egjiptian, ashkali, shqiptar dhe rom.**

Ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 janë identifikuar Gjithsej 113 braktisje nga sistemi arsimor i Kosovës. Sipas të dhënave për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 54 braktisje nga komuniteti egjiptian në rajonin e Pejës, 21 vajza dhe 33 djem.⁴⁰ Për klasat I deri në V- arsyet e përmendura përfshijnë, 'mungesë motivimi' dhe 'kushte të këqija ekonomike' si për vajzat ashtu edhe për djemtë, ndërsa arsyet e braktisjes për klasat VI deri në IX-përfshinin 'kujdesin për anëtarët e familjes, 'kushtet e këqija ekonomike' dhe 'mungesa e motivimit për vajzat, ndërsa djemtë e braktisën shkollën për shkak të 'kushteve të këqija ekonomike', 'mungesës së motivimit' dhe 'të qenit më i/e vjetër se shokët e klasës'.

Sipas të dhënave për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, 45 nxënës nga komuniteti egjiptian u kthyen me sukses në shkollë në rajonin e Pejës, 18 vajza dhe 20 djem. ⁴¹ Për klasat I deri në V arsyet e braktisjes së mundshme përfshinin 'mungesën e motivimit', 'kërkimin e lëmshës' dhe 'të qenit më i/e vjetër se shokët e klasës'. Për klasat VI deri në IX, 'kushtet e këqija ekonomike', 'kujdesi për vëllezërit e motrat', 'mungesa e motivimit' dhe 'të qenit më i/e vjetër se shokët e klasës' janë përmendur të gjitha si arsye. Ndërhyrjet e shkollave, komunave dhe shoqërisë civile kanë qenë të suksesshme për kthimin e nxënësve në shkollë. Në klasat I deri në V, ku arsyeja ishte 'mungesa e motivimit', EPRBM-ja komunale nga Gjakovë kontaktoi me familjet dhe filloi të bënte vizita të rregullta. Në një rast nga Istogu, DKA-ja ka kërkuar që shkolla të përgatisë orë mësimi shtesë për t'u mundësuar nxënësve që ta arrijnë mësimet që kanë munguar. Në mënyrë paralele, DKA ka informuar prindërit se Qendra për Punë Sociale (QPS) do të njoftohet se fëmijët nuk vijojnë rregullisht shkollën dhe se kjo mund të ndikojë në pagesat e tyre të asistencës sociale. Në Deçan, për një rast tjetër nga klasa I deri në V, komuna dhe një OJQ lokale kanë ndërhyrë dhe kanë inkurajuar prindërit të regjistrojnë sërish fëmijët për vitin e ardhshëm shkollor.

Ndërhyrjet për klasat VI deri në IX ku arsyeja ishte 'mungesa e motivimit' përfshinin vizitat e EPRBM-së e shkollës dhe ato komunale në familje në Gjakovë dhe Istog. Në dy raste kur vizitat nuk ishin efektive, letrat paralajmëruese informonin prindërit se çështja mund të përshkallëzohej në gjykata. Në Deçan, u organizua një takim i përbashkët në

40 Të dhënat e mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen e shkollës nga komuniteti egjiptian në rajonin e Pejës gjetën 54 braktisje të shkollës, dy vajza dhe gjashtë djem nga klasa I deri në V dhe 17 vajza dhe 27 djem nga klasa VI deri në IX.

41 Të dhënat e mbledhura nga ekipet e OSBE-së në terren ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, për nxënësit egjiptianë të kthyer në shkollë, 3 vajza dhe 6 djem nga klasa I deri në V dhe 15 vajza dhe 20 djem nga klasa VI deri në IX. Të dhënat për shtatë studentë nuk u zëbërthyen sipas gjinisë.

mes të ZKKK-së, anëtarëve të Komitetit për Komunitete (KK), përfaqësuesve të DKA-së, përfaqësuesve të Qendrës për Punë Sociale (QPS) si dhe prindërve dhe fëmijëve. Gjatë takimit, prindërit raportuan se nuk kishin mundësi t'i dërgonin fëmijët në shkollë për shkak të 'kushteve të këqija ekonomike'. Takimi rezultoi me mbështetjen e prindërve për t'u regjistruar në skemën e asistencës sociale. Në një rast tjetër në Deçan, komuna dhe një OJQ lokale i kanë mbështetur prindërit që t'i kthejnë fëmijët në shkollë.

Sipas të dhënave për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 43 braktisje nga komuniteti ashkali në rajonin e Pejës, 20 vajza dhe 23 djem.⁴² Për klasat I-V, arsyet e përmendura ishin 'shqetësimet e sigurisë', 'mungesa e motivimit' dhe çështjet familjare si për vajzat ashtu edhe për djemtë, ndërsa arsyet për braktisjen e klasave VI deri në IX përfshinin 'kujdesin për anëtarët e familjes', 'martesat e hershme' 'kushtet e këqija ekonomike' dhe 'mungesë motivimi' për vajzat, ndërsa djemtë e braktisën shkollën për shkak të 'mungesës së motivimit dhe 'të qenit më të vjetër se shokët e klasës'.

Sipas të dhënave për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, 18 nxënës nga komuniteti ashkali u kthyen me sukses në shkollë në komunën e Gjakovës, 11 vajza dhe shtatë djem.⁴³ Për klasat I deri në V, arsyet për vijimin e parregullt të shkollës përfshinin 'shqetësimet e sigurisë', 'mungesën e motivimit' dhe 'kushtet e këqija ekonomike', ndërsa arsyet e vijimit të parregullt për klasat VI deri në IX përfshinin 'kujdesin për anëtarët e familjes', 'kushtet e këqija ekonomike' dhe 'mungesën e motivimit'. EPRBM-të e shkollave dhe ato komunale vizituan familjet, pasuar nga një letër paralajmëruese nga DKA për drejtorin e shkollës, ku thuhej se rastet do të raportoheshin në gjykatë nëse fëmijët nuk do të vijonin shkollimin. Drejtori i shkollës ua komunikoi këtë prindërve dhe fëmijët u kthyen në shkollë.

Sipas të dhënave për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar dhjetë braktisje nga komuniteti shqiptar në rajonin e Pejës, një vajzë dhe nëntë djem.⁴⁴ Për klasat I deri në V dhe VI-IX arsyeja e përmendur ishte 'mungesa e motivimit'.

Sipas të dhënave për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, tre nxënës nga komuniteti shqiptar u kthyen me sukses në shkollë, dy vajza dhe një djalë, të gjithë nga klasa e VI deri në IX. "Mungesa e motivimit" ishte arsyeja e përmendur për secilin prej rasteve. Një rast, që kishte të bënte me një vajzë nga Istogu, u zgjidh pasi drejtori i shkollës dërgoi një raport në DKA duke kërkuar që të bëhet një plan për orët shtesë për

42 Të dhënat e mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen e shkollës nga komuniteti ashkali në rajonin e Pejës gjetën 43 braktisje të shkollës, tre vajza dhe 11 djem nga klasa I deri në V dhe 17 vajza dhe 11 djem nga klasa VI deri në IX.

43 Të dhënat e mbledhura nga ekipet e OSBE-së në terren ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, për nxënësit ashkali të kthyer në shkollë, pesë vajza dhe pesë djem nga klasa I deri në V dhe gjashtë vajza dhe dy djem nga klasa VI deri në IX.

44 Të dhënat e mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen e shkollës nga shqiptarët e Kosovës në rajonin e Pejës gjetën 10 braktisje gjithsej, një djalë nga klasa I në V dhe një vajzë dhe tetë djem nga klasa VI deri në IX.

të kompensuar orët e munguara. Në mënyrë paralele, prindërit janë njoftuar se komuna do të bashkërendohet me QPS-në ku kërkohet një certifikatë për vijimin e rregullt të shkollës për pagesat e asistencës sociale. Rastet tjera janë zgjidhur me vizita nga EPRBM-ja e shkollës.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar gjashtë (6) braktisje nga komuniteti rom në rajonin e Pejës, dy (2) vajza dhe katër (4) djem.⁴⁵ Për klasat I deri në V arsyet e përmendura ishin 'mungesa e motivimit' si për vajzat ashtu edhe për djemtë, ndërsa arsyet për klasat VI deri në IX përfshinin 'mungesën e motivimit' për vajzat dhe 'kushtet e këqija ekonomike' për djemtë.

Sipas të dhënave të OSBE-së për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, dy nxënës nga komuniteti rom u kthyen me sukses në shkollë në komunën e Gjakovës, një vajzë dhe një djalë, të dy nga klasa e VI deri në IX. Arsyet e përmendura ishin 'më i/e vjetër se shokët e klasës' dhe 'mungesa e motivimit'. Ndërhyrjet përfshinin vizita të rregullta nga EPRBM-ja e shkollës dhe ajo komunale, ku mësuesit ishin të përkushtuar që të monitorojnë vijimin dhe të raportojnë rregullisht tek EPRBM-të.

45 Të dhënat e mbledhura nga ekipet e OSBE-së në terren ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjet nga komuniteti rom në rajonin e Pejës gjetën gjashtë braktisje gjithsej, një vajzë dhe një djalë nga klasa I deri në V dhe një vajzë dhe tre djem nga klasa VI deri në IX.

Rajoni i Prishtinës

Komunat **Lipjan, Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Shtime në rajonin e Prishtinës janë duke përjetuar braktisje të klasave I-IX nga komuniteti ashkali, rom dhe shqiptar.** Gjithsej 88 braktisje nga sistemi arsimor i Kosovës janë identifikuar ndërmjet viteve 2020 dhe 2023.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 68 braktisje nga komuniteti ashkali dhe rom në rajonin e Prishtinës, 28 vajza dhe 40 djem.⁴⁶ Si për vajzat ashtu edhe për djemtë e klasave I deri në IX arsyet e përmendura ishin 'distanca fizike/mungesa e transportit', 'transporti i papërballueshëm', 'shqetësimet e sigurisë', 'shqetësimet e rendit publik (qentë endacakë, mungesa e trotuareve)', 'puna e fëmijëve', 'martesat e hershme/të detyruara', 'arsimimi i papërballueshëm', 'kujdesi për anëtarët e familjes', 'çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin', 'vendimi i prindërve', 'më i/e vjetër se shokët e klasës' dhe 'mungesa e motivimit'.

Sipas të dhënave për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, dy nxënës nga klasa I deri në V, një vajzë dhe një djalë nga komuniteti ashkali, ishin kthyer me sukses në shkollë në rajonin e Prishtinës. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në Shtime u informua se dy vëllezër e motra nuk po e vijonin shkollën, pasi nëna e tyre ishte e sëmurë. Kreu i ZKKK-së ka ndërhyrë dhe ka ndihmuar fëmijët të kthehen në shkollë.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 20 braktisje nga komuniteti shqiptar në rajonin e Prishtinës.⁴⁷ Arsyet nuk u dhanë për klasat I deri në V, ndërsa arsyet për vajzat dhe djemtë nga klasa VI deri në IX ishin 'kujdesi për anëtarët e familjes', 'distanca fizike/mungesë transporti', 'distanca fizike/e papërballueshme', 'shqetësimet e sigurisë', 'shqetësimet e rendit publik (qentë endacakë, mungesa e trotuareve)', 'puna e fëmijëve', 'martesat e hershme/të detyruara', 'arsimimi i papërballueshëm', 'çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin', 'vendimi i prindërve', 'më i/e vjetër se shokët e klasës' dhe 'mungesa e motivimit'.

46 Të dhënat e mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen nga komuniteti ashkali dhe rom në rajonin e Prishtinës gjetën 68 braktisje gjithsej. Zbërthimi i plotë sipas komuniteteve, gjinisë dhe klasave nuk ishte në dispozicion.

47 Të dhënat e mbledhura nga ekipet e OSBE-së në terren ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen nga komuniteti shqiptar në rajonin e Prishtinës gjetën 20 braktisje gjithsej, një djalë nga klasa I në V dhe një vajzë dhe gjashtë djem nga klasa VI deri në IX, ndërsa për 12 nxënës nuk pat të dhëna në dispozicion të zbërthyer sipas gjinisë.

Rajoni i Mitrovicës

Komunat **Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë Veriore, Vushtrri dhe Podujevë** në rajonin e Mitrovicës janë duke përjetuar braktisje më të shpeshtë të fëmijëve të klasave I deri në IX nga **komuniteti ashkali, shqiptar dhe rom**. Gjithsej 54 braktisje nga sistemi arsimor i Kosovës janë identifikuar ndërmjet viteve 2020 dhe 2023.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 21 braktisje nga komuniteti ashkali në rajonin e Mitrovicës, 13 vajza dhe tetë djem.⁴⁸ Për klasat I deri në V arsyeja e përmendur ishte 'mungesa e motivimit' për vajzën, ndërsa për klasat VI deri në IX arsytet përfshinin 'shqetësimet e sigurisë' dhe 'shëndetin' dhe 'më të vjetër se shokët e klasës' për vajzat dhe 'mungesa e motivimit' dhe 'vendimi i prindit si për djemtë ashtu edhe për vajzat.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 21 braktisje të shkollës nga komuniteti shqiptar në rajonin e Mitrovicës, gjashtë vajza dhe 15 djem.⁴⁹ Për klasat I deri në V arsytet e përmendura ishin 'shëndeti' dhe 'vendimi i prindit' për vajzat dhe 'kushtet e këqija ekonomike' dhe 'mungesa e motivimit' për djemtë, ndërsa për klasat VI deri në IX arsytet përfshinin 'shëndetin' dhe 'kushtet e këqija ekonomike' për vajzat dhe 'kushtet e këqija ekonomike', 'mungesa e motivimit' për djemtë.

Sipas të dhënave për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, katër nxënës nga komuniteti shqiptar u kthyen me sukses në shkollë, një vajzë dhe tre djem, nga Mitrovica e Jugut, Vushtrri dhe Skenderaj. Të gjithë nxënësit ishin nga klasa VI deri në IX dhe arsyeja e përmendur për vijimin e parregullt ishte 'mungesa e motivimit'. Në dy raste EPRBM-ja e shkollës ka pasur sukses në kthimin e fëmijëve në shkollë, ndërsa në dy rastet e tjera ka ndërhyrë EPRBM-ja e shkollës dhe ajo komunale.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 12 braktisje nga komuniteti rom në rajonin e Mitrovicës, pesë vajza dhe shtatë djem.⁵⁰ Për klasat I deri në V arsytet e përmendura ishin 'vendimi i prindit' dhe 'shëndeti' për vajzat dhe 'kushtet e këqija ekonomike' për djemtë që punojnë për të mbajtur familjen, ndërsa arsytet për klasat VI deri në IX përfshinin 'shkollimin e papërbalueshëm', 'kushtet e këqija ekonomike'. ' dhe të qenit 'më i vjetër se shokët e klasës' për djemtë.

48 Të dhënat e mbledhura nga ekipet e OSBE-së në terren ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen e shkollës nga komuniteti ashkali në rajonin e Mitrovicës gjetën 21 braktisje të shkollës, një vajzë nga klasa I deri në V dhe 12 vajza dhe tetë djem nga klasa VI deri në IX.

49 Të dhënat e mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen e shkollës nga komuniteti shqiptarë në rajonin e Mitrovicës gjetën 21 braktisje gjithsej, tre vajza dhe tre djem nga klasa I deri në V dhe tre vajza dhe 12 djem nga klasa VI deri në IX.

50 Të dhënat e mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen nga komuniteti rom në rajonin e Mitrovicës gjetën 12 braktisje të shkollës, dy vajza dhe pesë djem nga klasa I deri në V dhe tre vajza dhe dy djem nga klasa VI deri në IX.

Sipas të dhënave të OSBE-së për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, ishte një djalë nga klasa I deri në V nga komuniteti rom, i cili ishte kthyer me sukses në shkollë në komunën e Mitrovicës së Jugut. EPRBM-ja e shkollës kreu vizita informative në familjen e tij dhe e ktheu djalin në shkollë.

Rajoni i Prizrenit

Komunat **Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë**, dhe në një masë më të vogël, **Dragashi** në rajonin e Prizrenit janë duke përjetuar braktisje që kryesisht ndikon te fëmijët e klasave VI-IX nga **komuniteti shqiptar** dhe një numër më të vogël nga **komuniteti romë dhe egjiptian**. Gjithsej 33 braktisje nga sistemi arsimor i Kosovës janë identifikuar ndërmjet viteve 2020 dhe 2023.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 28 braktisje nga komuniteti shqiptar në rajonin e Prizrenit, pesë vajza dhe 23 djem.⁵¹ Për klasat I deri në V arsyeja e përmendur ishte 'vendim i prindit' si për vajzat ashtu edhe për djemtë, ndërsa arsyet për klasat VI deri në IX përfshinin 'shëndetin', 'kushtet e këqija ekonomike' dhe 'mungesën e motivimit' si për vajzat ashtu edhe për djemtë.

Sipas të dhënave për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, dy nxënës nga komuniteti shqiptar janë kthyer me sukses në shkollë, një vajzë dhe një djalë, nga klasa I deri në V nga Malisheva. Një rast është raportuar në DKA nga drejtori i shkollës. Megjithatë, rasti u raportua vonë gjatë vitit shkollor, kështu që fëmija u regjistrua sërish në klasën e parë vitin pasues, ku EPRBM-ja e shkollës dhe mësuesit do të mbikëqyrnin vijimin e shkollimit. Në rastin e dytë, nxënësja nuk ndihej rehat me fillimin e klasës së parë pasi i mungonte familja. Shkolla dhe prindërit vendosën së bashku që fëmija do të regjistrohej sërish në klasën e parë vitin e ardhshëm dhe shpresojnë që ajo të jetë mjaft e pjekur për t'u bashkuar me nxënësit e tjerë.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar tre braktisje nga komuniteti egjiptian në rajonin e Prizrenit. Të tre ishin djem nga klasa VI deri në IX. Arsyeja e përmendur për braktisjen ishte 'arsimimi i papërbalueshëm'.

Sipas të dhënave të OSBE-së për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, ishin shtatë nxënës, dy vajza dhe pesë djem, nga komuniteti rom në Prizren, të cilët u kthyen me sukses në shkollë. Të gjithë nxënësit ishin në klasat VI deri në IX dhe arsyet e vijimit të parregullt ishin 'vendimi i prindërve dhe 'gjendja e keqe ekonomike'. EPRBM-ja e shkollës dhe një OJQ lokale rregullisht vizituan familjet dhe i mbështetën me materiale shkollore.

51 Të dhënat e mbledhura nga ekipet e OSBE-së në terren ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për shqiptarët e Kosovës që braktisën shkollën në rajonin e Prizrenit gjetën 28 braktisje të shkollës, një vajzë dhe tre djem nga klasa I deri në V dhe katër vajza dhe 18 djem nga klasa VI deri në IX.

Sipas OJQ-së, rastet nuk janë regjistruar si braktisje të shkollës pasi OJQ-ja ka identifikuar mungesat e vazhdueshme dhe ka ndërhyrë së bashku me shkollën.

Rajoni i Gjilanit

Komuna e **Ferizajt**, dhe në masë më të vogël komuna e **Kaçanikut** në rajonin e **Gjilanit** janë duke përjetuar braktisje nga fëmijët e klasave I deri në IX nga **komuniteti ashkali** dhe një numër i vogël nga **komuniteti shqiptar**. Janë identifikuar gjithsej 23 braktisje nga sistemi arsimor i Kosovës ndërmjet viteve 2020 dhe 2023.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 19 braktisje nga komuniteti ashkali në rajonin e Gjilanit, nëntë vajza dhe dhjetë djem.⁵² Për klasat I deri në V, arsyeja e përmendur për djemtë ishte 'mungesa e motivimit', ndërsa 'mungesa e motivimit' u përmend gjithashtu si arsye për djemtë dhe vajzat nga klasa VI deri në IX. Sipas të dhënave për nxënësit në rrezik të braktisjes së arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, shtatë nxënës nga komuniteti ashkali ishin kthyer në shkollë, katër vajza dhe tre djem, në komunën e Ferizajt. Të gjithë nxënësit ishin në klasat VI deri në IX dhe arsyeja e përmendur ishte 'mungesa e motivimit'. Drejtuesit e shkollës, ZKKK, EPRBM-ja komunale dhe OJQ-të lokale mbajtën takime me nxënësit dhe prindërit dhe arritën t'i kthejnë të gjithë fëmijët në shkollë.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të obliguar të mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar katër braktisje nga komuniteti shqiptar në rajonin e Gjilanit. Të katër ishin djem nga klasa VI deri në IX. Arsyet e përmendura për braktisjen ishin 'kushtet e këqija ekonomike' dhe 'mungesa e motivimit'.

52 Të dhënat e mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen e shkollimit nga nxënësit ashkali në rajonin e Gjilanit gjeti gjithsej 19 braktisje, tre djem nga klasa I deri në IX dhe nëntë vajza dhe shtatë djem nga klasa VI deri në IX.



VII. Funksionimi i mekanizmave institucionalë të themeluar për të parandaluar braktisjen e shkollës


Ekipe funksionale të parandalimit dhe reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM)

EPRBM-të janë themeluar në shumicën e shkollave dhe komunave sipas Udhëzimit Administrativ 08/2018 për Krijimin dhe Forcimin e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në Arsimin Parauniversitar, sipas hulumtimit të ekipeve në terren të OSBE-së. Megjithatë, jo të gjitha janë plotësisht funksionale dhe as që të gjithë angazhojnë anëtarë të rinj pas skadimit të mandatit të anëtarëve. Një raport i vitit 2019 për EPRBM-të nga konsorciumi i OJQ-ve Kosint 2020 zbuloi se disa EPRBM-të të shkollave dhe komunave ishin krijuar vetëm në mënyrë administrative, se nuk po mbanin mbledhje të rregullta dhe shpesh i hodhën poshtë rastet e braktisjes së shkollës nga nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë si çështje kulturore që ata nuk ishin kompetentë për t'i trajtuar.⁵³ Doracakët për EPRBM-të e shkollave dhe komunave aktualisht janë duke u përditësuar, pra që nga viti 2023, që të përkufizojnë mekanizmat dhe mjetet për të ndihmuar komunat dhe shkollat të ushtrorin rolin dhe mandatin e tyre për parandalim, reagim dhe trajtim të braktisjes dhe mosregjistrimit në arsim në përputhje me Udhëzimin Administrativ të vitit 2018. Pasi që të botohen këta doracakë, mësimdhënësit, drejtuesit e shkollave dhe përfaqësuesit komunalë do të duhet të trajnohen për të siguruar që këta mekanizma janë plotësisht funksionale. EPRBM-të duhet të mbështeten në mënyrë të duhur për të zbatuar mandatin e tyre.

Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Arsimor (SMIA) përmban një veçori të integruar për të alarmuar për nxënësit të cilët rrezikojnë ta braktisin shkollën përpara se të braktisin zyrtarisht shkollën, i quajtur Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm. Pasi identifikohet një 'nxënës në rrezik', i karakterizuar nga mungesa të gjata ose vijim të parregullt, të gjitha institucionet përgjegjëse gjurmohen për trajtimin dhe referimin e rastit. Ky sistem parandalimi, nëse materializohet siç duhet, ka potencialin që të reduktojë në masë të madhe braktisjen. Sa më herët të identifikohen braktisjet, aq më

⁵³ Raporti i Vlerësimit për efektivitetin e EPRBM-ve, Raport i fokusuar në efektivitetin e EPRBM-ve te fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, faqe. 17, në dispozicion këtu [raporti i fokusuar në efektivitetin e prtanëve ndër romët-ashkali dhe fëmijët egjiptianë-1.pdf \(kosint2020.net\)](#)



shpejt mund të gjendet një zgjidhje përpara se një fëmijë të mungojë shumë gjatë në shkollë dhe arsyet e braktisjes të bëhen më të theksuara. Mësimdhënësit janë të parët që përdorin këtë mjet me monitorim të rregullt të vijimit të fëmijëve.

Mësuesit nga komunitetet

Të dhënat e MASHTI-t të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) kanë treguar një rritje të lehtë të numrit të mësimdhënësve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian ndërmjet viteve 2019 dhe 2023. Në vitin shkollor 2019/2020 kanë qenë 21 mësimdhënës nga të tri komunitetet,⁵⁴ ndërsa në vitin shkollor 2022/2023 kanë qenë 25 mësimdhënës nga të tri komunitetet.⁵⁵ Kohëve të fundit, MASHTI është përpjekur të inkurajojë më shumë studentë nga të tri komunitetet që të regjistrohen në fakultetin e edukimit për aftësimin e mësimdhënësve përmes bursave specifike. Megjithatë, për shkak të planifikimit të dobët dhe mungesës së përgatitjes dhe promovimit, kishte pak aplikantë dhe këto bursa janë devijuar diku tjetër. Rritja e numrit të mësimdhënësve të nivelit parashkollor, fillor dhe të mesëm nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian mund të ndikojë pozitivisht në përvojën arsimore për nxënësit. Mësimdhënës të tillë janë në pozitë të mirë për të shërbyer si shembuj dhe ndërmjetësues, si dhe si mësues, derisa trendi të përmirësohet.

Edukimi në fëmijërinë e hershme


Fëmijët që vijnë në programe cilësore parashkollore (0 deri në IV vjeç) janë më të përgatitur për fillimin e shkollës, kanë më shumë gjasa për të arritur standardet e leximit dhe matematikës në shkollën fillore dhe më pak gjasa të braktisin shkollën ose të përsërisin vitet në fazat e mëvonshme të shkollimit të tyre. Edukimi në fëmijërinë e hershme është thelbësor për të mësuarit e fëmijëve, shëndetin mendor dhe aftësitë sociale.⁵⁶ Përderisa vijimi i të gjithë fëmijëve nga të gjitha komunitetet në Kosovë në edukimin parashkollor (mosha pesëvjeçare) është sfidë pasi nuk ekzistojnë shërbime të mjaftueshme, fëmijët nga tri komunitetet më të cenueshme janë sërish më të prekurit. Pjesëmarrja e fëmijëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në programet parashkollore gjatë periudhës trevjeçare të raportimit është e ulët.⁵⁷ Këshilli i Evropës vlerëson se vetëm 49.5 për qind

54 Në vitin shkollor 2019/2020, gjashtë mësimdhënës ashkali, një në Ferizaj, një në Klinë, një në Rahovec, një në Shtime, një në Suharekë dhe një në Vushtri. Nëntë mësimdhënës romë, dy në Gjiilan, një në Kamenicë, një në Klinë dhe pesë në Prizren. Të dhënat nga Agjencia e Statistikave, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020, në dispozicion këtu, [ANG ASK.pdf \(rks.gov.net\)](#)

55 Në vitin shkollor 2022/2023, njëmbëdhjetë mësimdhënës romë, dy në Gjiilan, një në Kamenicë, një në Pejë dhe shtatë në Prizren. Shtatë mësimdhënës ashkali, një në Ferizaj, një në Klinë, një në Podujevë, një në Rahovec, një në Shtime, një në Suharekë dhe një në Vushtri. Shtatë mësimdhënës egjiptianë, një në Fushë Kosovë, tre në Gjakovë, një në Istog, një në Klinë dhe një në Pejë. Të dhëna nga Agjencia e Statistikave, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2022/2023., në dispozicion në gjuhën shqipe këtu, [Statistikat e arsimit në Kosovë 2022-2023 - MASHT \(rks.gov.net\)](#)

56 UNICEF, Qendrat e Fëmijërisë së Hershme u japin fëmijëve një fillim të mbarë, në dispozicion këtu, [Early childhood centers give children a head-start | UNICEF Kosovo Programme](#)

57 Sipas të dhënave të MASHTI-t të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin shkollor 2020/21 arsimin parafillor e kanë vijuar 84 romë, 206 ashkali dhe 61 fëmijë egjiptianë, gjithsej 351 fëmijë. Në vitin shkollor 2021/22,



e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë janë të përfshirë në edukimin parafillor, ndërsa përfshirja në edukim në vitet e hershme është shumë më e ulët.⁵⁸ Ligji i ri (Nr. 08/L-153) për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme përcakton që edukimi parafillor është i obligueshëm nga viti shkollor 2024-2025.⁵⁹ Prandaj është e domosdoshme që ofrimi i shërbimeve të zgjerohet, me investime dhe infrastrukturë adekuate, dhe që ndërgjegjësimi për ligjin e ri të shpërndahet te prindërit dhe komunitetet.

Tekstet shkollore falas

Tekstet shkollore për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në kurrikulën e Kosovës u janë ofruar të gjithë nxënësve pa pagesë që nga viti 2015. Ky hap inovativ nga Ministria e Arsimit ka ndihmuar në krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga gjendja e tyre socio-ekonomike. Në gusht të vitit 2023, Ministria e Arsimit njoftoi se në vend të ofrimit të librave shkollorë falas do të siguronin pagesa për prindërit përmes platformës e-Kosova për të blerë tekste shkollore për fëmijët e klasave I deri në V dhe për të ofruar tekste të përdorura për fëmijët e klasave më të larta. Ndryshimi në qasje preku në mënyrë disproporcionale tri komunitetet më të cënueshme. Kjo ishte për shkak se qasja në faqe ishte sfiduese dhe jo të gjitha libraritë kishin në dispozicion të gjithë librat. Prandaj, procedura e sapo paraqitur ka nevojë që të rishikohet për të siguruar që në vitin 2024 fëmijët të marrin librat e nevojshëm në kohë dhe në gjendje të mirë.

Mësimi plotësues

Për fëmijët që nuk janë regjistruar me kohë në klasën e parë ose që kanë pasur mungesa të gjata në shkollë, mësimi plotësues i ofruar nga shkollat mund të përshejtojnë të mësuarit e tyre dhe, së bashku me planet individuale të të mësuarit të zhvilluara nga mësuesit, mund t'ua mundësojnë atyre të hyjnë ose të ri-hyjnë në mjedisin e klasës me njohuritë bazë që nevojiten për zhvillim të mëtejshëm. Shkollat dhe komunat duhet të ndajnë informacione mbi atë se cilët nxënës mund të kenë nevojë për një përkrahje të tillë plotësuese dhe të ofrojnë programe të rregullta. Kjo aktualisht është duke ndodhur vetëm në baza ad-hoc dhe varet shumë nga disponueshmëria e fondeve brenda komunës.

arsimin parafillor e kanë vijuar 83 romë, 250 ashkali dhe 41 fëmijë egjiptianë, gjithsej 374 fëmijë. Në vitin shkollor 2022/23 arsimin parafillor e kanë vijuar 74 romë, 221 ashkali dhe 74 fëmijë egjiptianë, gjithsej 323 fëmijë.

58 Këshilli i Evropës, Studimi hartëzues, analizë e ndërhyrjeve dhe arritjeve të projekteve të ndryshme që mbështesin përfshirjen në arsim të djemve dhe vajzave romë, ashkali dhe egjiptianë, 2020, në dispozicion këtu, [1680a0b095 \(coe.int\)](#)

59 Ligji Nr.08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Neni 37, Dispozitat Kalimtare, Arsimi parafillor bëhet i detyrueshëm nga viti shkollor 2024-2025, në dispozicion këtu, [ActDetail.aspx \(rks-gov.net\)](#)



VIII. Funkcionimi i reagimit joinstitucional të krijuar për të parandaluar braktisjen e shkollës

Qendrat mësimore

Qendrat mësimore që mbështesin fëmijët për të qëndruar në shkollë kanë qenë pjesë e peizazhit të OJQ-ve për gati 20 vjet. Ato ofrojnë programe të ndryshme, si ndihmë për detyrat e shtëpisë, aktivitete jashtëkurrikulare, kampe verore dhe dimërore, ushqim, materiale shkollore, mësim prindëror dhe asistencë për arsimimin e grave, ndër shërbimet tjera, duke ndihmuar në plotësimin e hendekut midis ofrimit të arsimit komunitetin shumicë dhe ato joshumicë. Në vitin 2018, OJQ-të dhe Ministria e Arsimit u bashkuan për të hartuar legjislacionin që të rregullojë më mirë funksionimin e qendrave mësimore dhe për të ofruar mbështetje nga fondet qendrore dhe komunale. Përveç thirrjes vjetore për financim nga MASHTI që nga viti 2021 dhe mbështetjes ad hoc nga komunat, ky 'institucionalizim' i qendrave mësimore ka ngecur dhe ato vazhdojnë të mbyllen për shkak të mungesës së fondeve.⁶⁰ OJQ-të lokale, donatorët ndërkombëtarë, BE-ja, UNICEF-i dhe Këshilli i Evropës, së bashku me OSBE-në vazhdojnë të avokojnë për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit përkatës për ruajtjen e këtyre ofruesve të rëndësishëm të arsimit.

Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi është dëshmuar si masë efektive nga OJQ-të për të bërë ndërlidhjen midis prindërve dhe shkollave dhe për të rritur ndërgjegjësimin për obligimet e prindërve, rëndësinë e arsimit dhe për të zbutur faktorët që mund të kontribuojnë në vijimin e parregullt në shkollë. Shumë nga këto aktivitete të ndërmjetësimit janë financuar nga donatorët, por disa autoritete lokale kanë angazhuar ndërmjetësues nga komunitetet për të trajtuar në mënyrë aktive braktisjen e shkollës në komunat e tyre. Një studim hartografik i Këshillit të Evropës për ndërhyrjet dhe arritjet e projekteve gjithëpërfshirëse përmendi ndërmjetësimin si një praktikë të mirë për mbështetjen e arsimit të fëmijëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.⁶¹

60 Për më shumë informacion mbi qendrat mësimore, shih Raportin e OSBE-së, Pasqyrë e Përgjithshme e Qendrave Mësimore në Kosovë dhe Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 19/2018, 2023, në dispozicion këtu: [Pasqyrë e Qendrave Mësimore në Kosovë dhe Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 19/2018 | OSBE](#)

61 Këshilli i Evropës, studim hartografik, Analizë e ndërhyrjeve dhe arritjeve të ndryshme që mbështesin përfshirjen në arsim të djemve dhe vajzave romë, ashkali dhe egjiptianë, tetor 2020, në dispozicion këtu: [1680a0b095 \(coe.int\)](#)



IX. Përmbyllje

Përderisa është e vërtetë se braktisja e shkollës nuk është më problem sistematik për Kosovën në përgjithësi, ky problem ende është i pranishëm në disa komuna specifike. Kjo situatë është më e rëndë për vajzat dhe djemtë ashkali, egjiptianë dhe romë, ndonëse është duke ndodhur edhe te komunitetin shqiptar, ndonëse në një masë më të vogël. Të dhënat mbledhen përmes sistemit të informacionit të menaxhimit arsimor, por cilësia e të dhënave është e kontestueshme, me pak analiza dhe pak përcjellje të trendeve në zhvillim. Ndonëse është në fuqi kuadri legjislativ për uljen e braktisjes nga arsimi i detyrueshëm, rastet neglizhohen apo nuk përcillen në mënyrë të kënaqshme. Diskriminimi dhe varfëria e vazhdueshme, e cila është përkeqësuar nga inflacioni i lartë dhe kufizimet si pasojë e pandemisë Covid-19, kanë rënduar situatën për shumë familje, të cilat e kanë më të vështirë t'i përballojnë presionet financiare. Shumë akterë që kanë ndikim ose përgjegjësi për të parandaluar braktisjen nga shkolla nuk gëzojnë mbështetje adekuatë: mësime të mëdha kanë nevojë për trajnim, EPRBM-të dhe OJQ-të kanë nevojë për financim, DKA-të kanë nevojë për resurse, prindërit kanë nevojë për edukim, si dhe fëmijët kanë nevojë për motivim. Në zonat me shkallë më të lartë të braktisjes së shkollës, përfshirë në Gjakovë, Fushë Kosovë, Shtime, Prizren dhe Prishtinë, këto mungesa kërkojnë përpjekje të konsoliduara dhe të përqendruara për t'i përmbysur trendet negative. Nevojiten ndërhyrje të targetuara për t'i trajtuar shkaqet bazë që prekin vajzat dhe djemtë nga komunitetet specifike.

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i akterëve kryesorë për adresimin e çështjeve specifike ndihmon që fëmijët të mbështeten për t'u kthyer në shkollë ose për të parandaluar braktisjen e shkollës para se kjo të ndodhë. Për shembull, në komunën e Pejës, më 2022 DKA-ja ka pranuar kërkesë nga Komiteti për Komunitete (KK) për të ofruar transport falas për 85 nxënës egjiptianë dhe romë, të cilët duhej të udhëtonin më shumë se 3.5 km deri në shkollën e tyre më të afërt, pasi gjashtë fëmijë kishin braktisur shkollën për shkak të mungesës së transportit dhe kushteve të këqija socio-ekonomik. Gjithashtu, më 2022, me mbështetje të OSBE-së, MASHTI ka organizuar tri tryeza të rrumbullakëta në Istog, Klinë dhe Gjakovë, për adresimin e çështjes së braktisjes së shkollës në mesin e komuniteteve egjiptianë, romë dhe ashkali. MASHTI ka nxjerrë rekomandime specifike bazuar në moshën dhe kohën që fëmijët kanë qenë jashtë shkollës. Në mesin e rekomandimeve ishin edhe vlerësimet, përsëritja e vitit shkollor, mësimi plotësues, aktivitetet angazhuese, koordinimi me prindërit dhe sigurimi i transportit. Përmes kësaj ndërhyrjeje u identifikuan 17 nxënës që kishin braktisur shkollën, prej të cilëve shtatë janë kthyer në shkollë me mbështetje të DKA-së dhe veprimeve të drejtpërdrejta të MASHTI-t.



X. Rekomandime

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

- **Strategjia për avancimin e komunitetit rom dhe ashkali në Kosovë:** Të zbatohen të gjitha aktivitetet arsimore të përfshira në planin e veprimit, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me braktisjen e shkollës.
- **Trajnime mbi SMIA:** Të organizohen trajnime të rregullta dhe të përditësuara mbi SMIA për mësuesit dhe menaxhmentin e shkollës.
- **Analizimi i të dhënave:** Të analizohen të dhënat për t'i identifikuar modelet dhe arsyet më të shpeshta për braktisje të shkollës për t'i përshtatur strategjitë e ndërhyrjes dhe parandalimit.
- **Trajnimi i vazhdueshëm i mësimeve:** Të ofrohen trajnime të vazhdueshme për mësimeve për të rritur aftësitë e tyre në trajtimin e nevojave të nxënësve, duke njohur shenjat e shqetësimit dhe duke ofruar mbështetjen e duhur.
- **Hetimi i zonave ku ka braktisje të lartë të shkollës:** Të ndërmerren veprime përcjellëse te komuna e identifikuar te cilat braktisja e shkollës është e shpeshtë.
- **EPRBM-të funksionale:** Të sigurohet që EPRBM e nivelit qeveritar është funksionale; të mbahen takime të rregullta dhe efikase dhe të hartohen raporte.
- **Mbështetja e OJQ-ve:** Të ofrohet mbështetje adekuate për OJQ-të që punojnë me Qendrat Mësimore, ndërmjetësuesit ose për aktivitete të tjera që synojnë uljen e braktisjes.
- **Ndërhyrjet e targetuara:** Të sigurohet që fushatat e ndërgjegjësimit për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe shqiptar janë hartuar e përshtatur enkas për atë qëllim.
- **Rritja e numrit të mësimeve nga komunitetet:** Të nxiten nxënësit e shkollave të mesme nga tri komunitetet e cënueshme për t'u bërë mësimeve.
- **Edukimi parashkollor:** Të sigurohen vendeve në nivelin parashkollor për të gjithë fëmijët, ashtu siç rregullohet me Ligjin për edukimin në fëmijërinë e hershme. Të informohen prindërit për rëndësinë e dërgimit të fëmijëve në edukimin parashkollor.
- **Kurrikula angazhuese:** Të përfshihet arsimi ndërkulturor në kurrikulat shkollore.
- **Tekstet shkollore pa pagesë:** Të vazhdojë ofrimi i teksteve shkollore falas për nxënësit në arsimin e obligueshëm.

Drejtoritë Komunale të Arsimit:

- **Planet lokale të veprimit:** Të përfshihen në Planet Lokale të Veprimit dhe të zbatohen aktivitetet për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e Romëve dhe Ashkalive në Kosovë.
- **Mbledhja dhe zëbrthimi i të dhënave:** Të sigurohet që të dhënat e mbledhura lidhur me braktisjen e shkollës zëbrthehen sipas komunitetit, gjinisë dhe klasës.

- **Trajnimi mbi SMIA:** Të ofrohen trajnime për mbledhjen e të dhënave në SMIA, për stafin arsimor dhe menaxhmentin e shkollës.
- **EPRBM funksionale:** Të ofrohet mbështetje adekuate e EPRB-ve të nivelit shkollor dhe komunal dhe të sigurohet që ato takohen dhe raportojnë rregullisht.
- **Ofrimi i mbikëqyrjes efektive:** Të monitorohen nga afër shkollat me braktisje të lartë dhe mbështetja e tyre përmes strategjive parandaluese.
- **Mbështetja për OJQ-të:** Të sigurohet mbështetje adekuate e OJQ-ve që punojnë me Qendrat Mësimore, ndërmjetësit ose që zhvillojnë veprime të tjera që ulin në mënyrë aktive braktisjen e shkollës.
- **Ndërhyrjet e targetuara:** Të sigurohet që fushatat e ndërgjegjësimit për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali, egjiptian janë hartuar e përshtatur enkas për atë qëllim.
- **Vlerësimi i nevojave për transport:** Të sigurohet që të gjithë fëmijët kanë transport adekuat për të shkuar dhe kthyer nga shkolla.
- **Mësimi plotësues:** Të sigurohen fonde për mësim plotësues për fëmijët që fillojnë klasën e parë me vonesë ose që kanë vijim të parregullt në shkollë.
- **Edukimi parashkollor:** Të sigurohen shërbime adekuate për edukimin parashkollor.

Shkollat

- **Monitorimi i rregullt i vijueshmërisë:** Të monitorohet nga afër vijueshmëria dhe të ndërhyhet nëse nxënësit shfaqin shenja të vijueshmërisë së parregullt. Ndërhyrja e hershme mund të parandalojë shkëputjen e mëtejshme. Të dhënat të futen në SMIA dhe sistemin e paralajmërimit të hershëm.
- **Programet e ndërhyrjes së hershme:** Të zbatohen programet e ndërhyrjes së hershme për t'i identifikuar nxënësit që mund të jenë në rrezik të braktisjes së shkollës. Kjo mund të përfshijë vlerësime të rregullta të performancës dhe sjelljes akademike të nxënësve.
- **Mbështetja e individualizuar:** Të ofrohet mbështetje e individualizuar për nxënësit që përballen me sfida. Këtu mund të përfshihen programe mësimore, këshillime ose mentorime të përshtatura enkas për nevojat e tyre specifike.
- **Mjedis mbështetës:** Të krijohet një mjedis shkollor mbështetës dhe gjithëpërfshirës ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të respektuar.
- **Përfshirja e prindërve:** Të inkurajohet përfshirja e prindërve përmes komunikimit të rregullt, takimeve dhe seminareve prindër-mësues.
- **Lartësimi i arritjeve:** Të vlerësohen dhe lartësohen arritjet e nxënësve, si ato akademike ashtu edhe joakademike, për të rritur vetëvlerësimin dhe motivimin për të qëndruar në shkollë.

OJQ-të që punojnë në çështje të arsimit dhe uljes së braktisjes së shkollës

- **Ndarja e informatave:** Të sigurohet se informatat për braktisjen individuale të shkollës ose fëmijët në rrezik të braktisjes së shkollës ndahen me shkollat dhe DKA-të.
- **Rritja e ndërgjegjësimit:** Të rritet ndërgjegjësimi për çështjet ligjore dhe sociale, dhe komplikimet fizike nga martesat e hershme.
- **Kundër-diskriminimi:** Të hartohen aktivitete që përfshijnë komponentë kundër diskriminimit.
- **Inkurajimi i përfshirjes së prindërve:** Të punohet me prindërit për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e edukimit të hershëm dhe qëndrimit në shkollë.
- **Planet lokale të veprimit:** Të punohet me komunat për t'i mbështetur aktivitetet e përfshira në planet lokale të veprimit për të adresuar dhe parandaluar braktisjen e shkollës.

SHTOJCA 1

Të dhënat e MASHTI-t për braktisjen e shkollës në periudhën 2019-2023, për vajzat dhe djemtë shqiptarë, ashkali, romë dhe egjiptianë, të ndara sipas klasës dhe komunës. Të dhënat më të larta janë paraqitur së pari.

Rajoni i Pejës

Gjakovë													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1	1	0	1	4	1	5	0	0	0	2	0	2	8
Klasa 2	2	0	2	1	1	2	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 3	1	2	3	0	1	1	0	0	0	3	0	3	7
Klasa 5	1	1	2	0	3	3	0	0	0	1	0	1	6
Klasa 6	2	1	3	0	0	0	0	0	0	2	0	2	5
Klasa 7	2	2	4	1	1	2	0	0	0	0	1	1	7
Klasa 8	2	2	4	0	1	1	0	0	0	0	1	1	6
Klasa 9	2	1	3	0	0	0	0	0	0	0	1	1	4
Nën-totali	13	9	22	6	8	14	0	0	0	8	3	11	47
2020/2021													
Klasa 1	0	0	0	1	1	2	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 2	0	0	0	2	1	3	0	0	0	0	1	1	4
Klasa 3	0	0	0	3	0	3	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 4	0	0	0	3	2	5	0	0	0	1	0	1	6
Klasa 5	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	0	0	0	0	3	3	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 7	0	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 8	0	0	0	0	1	1	1	0	1	0	0	0	2
Klasa 9	1	0	0	0	3	3	0	0	0	0	0	0	4
Nën-totali	1	0	1	11	12	23	1	0	1	1	1	2	27
2021/2022													

Klasa 1	1	0	1	3	0	3	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Klasa 4	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	1	0	1	1	0	1	0	0	0	1	0	1	3
Nën-totali	2	0	2	5	1	6	0	0	0	2	0	2	10
2022/2023													
Klasa 1	0	1	1	1	1	2	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 2	1	0	1	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 3	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	1	1	2
Klasa 4	0	0	0	1	1	2	0	1	1	0	0	0	3
Klasa 8	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	1	1	2
Klasa 9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	2
Nën-totali	1	1	2	3	4	7	0	1	1	0	4	4	14
GJITHSEJ	17	10	27	25	25	50	1	1	2	11	8	19	98

Istog													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 3	1	2	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Nën-totali	1	2	3	0	0	0	0	0	0	1	0	1	4
2020/2021													
Klasa 1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	1	5	5
Klasa 3	0	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Klasa 9	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	0	0	0	3	0	3	0	0	0	5	1	6	9
2021/2022													
Klasa 6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	2
Klasa 7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	2	2
Klasa 8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Nën-totali	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	3	5	5
2022-2023													
Klasa 1	0	0	0	3	2	5	0	0	0	0	1	1	6
Klasa 2	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Klasa 5	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7	3	10	10
Klasa 7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	2
Klasa 8	0	2	2	0	0	0	0	0	0	1	1	2	4
Klasa 9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nën-totali	0	2	2	4	3	7	0	0	0	9	7	16	25
GJITHSEJ	1	4	5	7	3	10	0	0	0	17	11	28	43

Klinë													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 6	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	1	0	1	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2022/2023													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nën-totali	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	2
GJITHSEJ	1	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	2

Deçan													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2022/2023													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Rajoni i Prishtinës

Fushë Kosovë													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1	1	1	2	3	3	6	0	0	0	0	0	0	8
Klasa 4	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 5	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 8	0	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	1	1	2	6	4	10	0	0	0	0	0	0	12
2020/2021													
Klasa 1	0	0	0	2	2	4	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 3	0	0	0	3	2	5	0	0	0	0	0	0	5
Klasa 4	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 5	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 7	0	0	0	2	4	6	0	0	0	0	0	0	6
Klasa 8	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nën-totali	1	2	3	7	9	16	0	0	0	0	0	0	19
2021/2022													
Klasa 1	0	0	0	1	2	3	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 3	0	0	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	2

Klasa 4	0	0	0	1	3	4	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 5	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	0	0	0	5	1	6	0	0	0	0	0	0	6
Klasa 7	0	0	0	2	1	3	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 8	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	0	0	0	9	12	21	0	0	0	0	0	0	21
2022/2023													
Klasa 2	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 3	1	0	1	1	1	2	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 4	0	0	0	1	0	1	0	1	1	0	0	0	2
Klasa 5	1	1	2	0	1	1	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 6	1	0	1	8	4	12	0	0	0	0	0	0	13
Klasa 7	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 8	0	1	1	0	4	4	0	0	0	1	0	1	6
Klasa 9	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	4	3	7	11	10	21	0	1	1	1	0	1	30
GJITHSEJ	6	6	12	33	35	68	0	1	1	1	0	1	82

Lipjan													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1	1	2	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 2	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 3	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 6	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 7	0	1	1	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 8	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nën-totali	6	5	11	0	1	1	0	0	0	0	0	0	12
2020/2021													
Klasa 1	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 2	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 4	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	0	0	0	1	1	2	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 8	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	2	1	3	2	2	4	0	0	0	0	0	0	7
2021/2022													
Klasa 1	1	0	1	1	1	2	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 2	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 3	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 7	0	0	0	3	0	3	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 8	0	0	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	2	4	6	4	3	7	0	0	0	0	0	0	13
2022/2023													
Klasa 1	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 3	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 8	0	0	0	0	2	2	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	2	1	3	0	2	2	0	0	0	0	0	0	5
GJITHSEJ	12	11	23	6	8	14	0	0	0	0	0	0	37

Obiliq													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	00	0	0
2021/2022													
Klasa 9	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
2022/2023													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1

Shtime													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 7	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2022/2023													
Klasa 5	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 8	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
GJITHSEJ	5	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5

Prishtinë													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 3	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 5	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 7	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	6	3	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9
2020/2021													
Klasa 1	1	2	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 7	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 8	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 9	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	6	3	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9
2021/2022													
Klasa 1	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 8	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	4	2	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
2022/2023													
Klasa 4	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1

Klasa 8	1	0	1	1	0	1	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 9	1	0	1	0	0	2	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	2	0	2	2	0	2	0	0	0	0	0	0	4
GJITHSEJ	18	8	26	2	0	2	0	0	0	0	0	0	28

Rajoni i Mitrovicës

Mitrovicë Jugore													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 9	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2022/2023													
Klasa 7	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Nën-totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
GJITHSEJ	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2

Mitrovicë e Veriut													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2022/2023													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Vushtrri													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 7	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2020/2021													
Klasa 7	3	2	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
Nën-totali	3	2	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
2021/2022													
Klasa 7	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2022/2023													
Klasa 8	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
GJITHSEJ	5	3	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8



Podujevë													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			Gjithsej
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
2022/2023													
Klasa 6	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 7	0	0	0	3	0	3	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 9	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	0	0	0	3	2	5	0	0	0	0	0	0	5
GJITHSEJ	0	0	0	4	2	6	0	0	0	0	0	0	6

Rajoni i Prizrenit

Prizren													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			Gjithsej
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	
Klasa 1	4	1	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
Klasa 7	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 8	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	2	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Nën-totali	7	3	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10
2020/2021													
Klasa 4	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	0	0	0	0	0	0	2	0	2	0	0	0	2
Klasa 9	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	1	1	2	0	0	0	2	0	2	0	0	0	4
2021/2022													
Klasa 8	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2022/2023													
Klasa 1	2	2	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 3	0	1	1	0	0	0	0	2	2	0	0	0	3
Klasa 4	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 5	2	2	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 6	5	2	7	4	0	4	0	0	0	0	0	0	11
Klasa 7	8	1	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9
Klasa 8	3	1	4	0	2	2	0	0	0	0	0	0	6
Klasa 9	2	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Nën-totali	23	10	33	4	2	6	0	2	2	0	0	0	41
GJITHSEJ	32	14	46	4	2	6	2	2	4	0	0	0	56



Suharekë													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			Gjithsej
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1	0	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	0	0	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	2
2022/2023													
Klasa 3	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 4	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 5	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 7	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 8	2	1	3	1	0	1	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 9	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	5	4	9	1	0	1	0	0	0	0	0	0	10
GJITHSEJ	5	4	9	1	0	3	0	0	0	0	0	0	12

Rahovec													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			Gjithsej
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	
Klasa 6	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2022/2023													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1

Malishevë													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			Gjithsej
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	
Klasa 2	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 3	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 4	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	3	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Klasa 7	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 9	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	6	5	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	11
2020/2021													
Klasa 1	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	3	1	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
Klasa 7	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 8	3	1	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
Nën-totali	8	2	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10

2021/2022													
Klasa 6	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
2022/2023													
Klasa 1	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 8	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	4	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
GJITHSEJ	19	8	27	0	0	0	0	0	0	0	0	0	27

Dragash													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2022/2023													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Rajoni i Gjilanit

Ferizaj													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2020/2021													
Klasa 1	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Klasa 4	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 6	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 7	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 8	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	2	0	2	4	1	5	0	0	0	0	0	0	7
2021/2022													
Klasa 1	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Nën-totali	0	0	0	1	1	2	0	0	0	0	0	0	2
2022/2023													
Klasa 6	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Klasa 9	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Nën-totali	1	2	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
GJITHSEJ	4	2	6	5	2	7	0	0	0	0	0	0	13



Kaçanik													
2019/2020													
	Shqiptarë			Ashkali			Romë			Egjiptianë			
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	Gjithsej
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2020/2021													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2021/2022													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2022/2023													
Klasa 1-9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0



